6

Strasburg, 6 shkurt 1991

Zoti Kryetar,

Ne shtatorin e kaluar, zoti Çela dhe zonja Dhimitri, dy anetare te shquar te Kuvendit tuaj, moren pjese ne debatin mbi bashkepunimin dhe sigurimin ne Evrope, organizuar nga Asambleja Parlamentare e Keshillit te Evropes.

Interesimit te shfaqur nga Kuvendi Popullor i Shqiperise per te marre pjese ne veprimtarite e Keshillit te Evropes ne iu pergjigjem me deshiren per te ndjekur zhvillimet ne vendin tuaj ne kuadrin e bashkepunimit parlamentar gjithevropian, te cilin Asambleja jone shpreson te çoje me perpara. Nisur pikerisht nga kjo fryme, ajo i dha statusin e te ftuarit special Bullgarise, Rumanise, Jugosllavise, Bashkimit Sovjetik dhe Republikes Çeke e Sllovake, e cila me 21 shkurt do te behet anetare me te drejta te plota e Keshillit te Evropes.

Ne kuadrin e ketij bashkepunimi gjithevropian, prej kohesh eshte bere praktike qe Asambleja te ndjeke zgjedhjet legjislative ne shtetet joanetare te Keshillit te Evropes. Per kete, ajo cakton nje delegacion vezhguesish prej 10 anetaresh te saj, mbi bazen e propozimeve te grupeve te saj te ndryshme politike. Ne kete menyre ajo ka ndjekur zgjedhjet ne Republiken Demokratike Gjermane ne mars 1990, ne Hungari ne prill 1990, ne Rumani ne maj dhe ne Çekosllovaki dhe Bullgari qershorin e kaluar.

Ne emer te Byrose se Asamblese Parlamentare, me lejoni t´ju sugjeroj qe edhe Asambleja jone te ftohej per te ndjekur zgjedhjet e ardhshme legjislative ne Shqiperi, te parashikuara per me 31 mars dhe 14 prill 1991.

Ju lutem, pranoni, zoti kryetar, sigurimin e konsiderates sime te larte.

Anders Bjork

ZOTIT PETRO DODE
KRYETAR I KUVENDIT POPULLOR
TE RPS TE SHQIPERISE
T I R A N E

REPUBLIC OF ALBANIA
MINISTRY OF FOREIGN AFFAIRS
The Minister

Tirana, 18 August 1991

Distinguished General Secretary,

I have the particular pleasure to address myself to You, in your capacity as General Secretary of the Council of Europe, to let you know and ask for your kind assistance on a vital question of the democratic process in Albania.

As you are aware, Albania is now totally involved in the important processes for the construction of a democratic pluralist society, based on the rule of law, the recognition and respect of the human rights.

The work for the drafting of our new Constitution occupies, no doubt, a focal place in this process. Studying and mastering the experience of other countries, as well as consulting renown experts of the constitutional right from these countries, assume special significance for us today. This is even more indispensable for our country, if we bear in mind the great difficulties and lack of expertise on our part for such an important undertaking.

To this end, we are studying the possibility of organizing a topical 2-3 days seminar in our country, during the second half of October, on questions related to the drafting of our new Constitution, in which we intend to invite well-known experts from international bodies and other countries to make their contributions.

H.E. Mrs. Catherine LALUMIERE
General Secretary of the
Council of Europe
STRASBOURG

17

I would be grateful if I could receive a positive reaction on this question from your part. We would be honoured if we could have the assistance and support of the Council of Europe in this respect, for the successful organization of this activity. The contribution to the discussion in this seminar of your representatives, too, would be highly appreciated. This would be a good outset on the road of a fruitful cooperation which has already started between the Council of Europe and Albania for the good of the new democracy in our country.

Looking forward to an ever fruitful and increased cooperation with the Council of Europe, please accept distinguished Mrs. General Secretary, the assurances of my highest consideration.

Sincerely yours,

MUHAMET KAPLLANI

16

REPUBLIC OF ALBANIA
MINISTRY OF FOREIGN AFFAIRS
The Minister

Tirana, 18 August 1991

Distinguished General Secretary,

I have the particular pleasure to address myself to You, in your capacity as General Secretary of the Council of Europe, to let you know and ask for your kind assistance on a vital question of the democratic process in Albania.

As you are aware, Albania is now totally involved in the important processes for the construction of a democratic pluralist society, based on the rule of law, the recognition and respect of the human rights.

The work for the drafting of our new Constitution occupies, no doubt, a focal place in this process. Studying and mastering the experience of other countries, as well as consulting renown experts of the constitutional right from these countries, assume special significance for us today. This is even more indispensable for our country, if we bear in mind the great difficulties and lack of expertise on our part for such an important undertaking.

To this end, we are studying the possibility of organizing a topical 2-3 days seminar in our country, during the second half of October, on questions related to the drafting of our new Constitution, in which we intend to invite well-known experts from international bodies and other countries to make their contributions.

H.E. Mrs. Catherine LALUMIERE
General Secretary of the
Council of Europe
STRASBOURG

1

**REPUBLIKA E SHQIPERISE**
**MINISTRIA E PUNEVE TE JASHTME**

DREJTORIA E BASHKEPUNIMIT SHUMEPALESH
DHE ORGANIZATAVE NDERKOMBETARE

Tirane, me 9.11.1991

Nr. 5822/1

L e n d a: <u>Mbi bashkepunimin me Keshillin e Evropes</u>.

MINISTRISE SE KULTURES, RINISE E SPORTEVE
( Zotit Preç Zogaj )

<u>T I R A N E</u>

Ne kuadrin e orientimit te ri te veprimtarise e politikes se jashtme te vendit tone ne proçeset evropiane, nje prioritet baze perben fillimi i bashkepunimit dhe integrimi sa me i shpejt e me i plote i Shqiperise ne Keshillin e Evropes, qe perfaqeson institucionin kryesor per bashkepunimin ne fushat politike, sociale, ligjore, kulturore, humanitare, arsimore, etj. Siç mund te jeni ne dijeni, tashme jane vendosur kontaktet e para me kete organizem dhe jane organizuar nje sere aktivitetesh.

Kohet e fundit, Keshilli i Evropes ka shprehur gatishmerine e tij per te fuqizuar e zhvilluar bashkepunimin me vendin tone dhe per kete qellim ka ndermarre nje sere inciativash. Ne kete kuader, Shqiperia eshte ftuar per te aderuar ne Konventen Kulturore Evropiane, si hapi i pare drejt perfshirjes se plote te Shqiperise ne kete organizem. Keshilli i Evropes ka njoftuar se eshte i gatshem te prese ne Strasburg nje delegacion nga vendi yne te perbere prej 4-5 ekspertesh te fushave te kultures, arsimit, trashegimise, rinise, sporteve etj, per te diskutuar aspektet politike e praktike te ketij aderimi te mundshem, si dhe kerkon qe t'i bejme te ditur datat e mundshme te kesaj vizite. Shpenzimet e udhetimit e te qendrimit perballohen nga Keshilli i Evropes.

Jemi te mendimit qe ne perberje te ketij delegacioni nga dikasteri juaj te jete nje Drejtor Drejtorie, i cili do ta kryesoj ate, si dhe nje specialist tjeter qe trajton keto probleme. Sugjerojme qe si data te mundshme per viziten e delegacionit tone ne Strasburg te jene 3-6 dhjetor 1991.

Mendojme qe te fillojne menjehere pergatitjet per realizimin e kesaj vizite dhe veçanerisht per aderimin ne Konventen Kulturore Evropiane, tekstin e se ciles ua dergojme bashkelidhur.

Lutemi na beni te ditur sa me pare personat e dikasterit tuaj qe do te bejne pjese ne delegacion dhe mendimin tuaj per kohen e vizites, me qellim qe te njoftojme Keshillin e Evropes.

Per çdo problem lidhur me sa me siper mund te kontaktoni me Drejtorine e Bashkepunimit Shumepalesh dhe Organizatave Nderkombetare.

ZEVENDESMINISTRI

( Mehill Marku )

9.11.1991

Nr. 39

K. E.
B. VI 2

Sh. Ylli

1

S h e n i m:

Me 13-14 shtator dhe me 17-18 shtator 1991, ministri i Jashtem eshte ftuar per te marre pjese perkatesisht ne mbledhjen e Venecias te Komisionit te Keshillit te Evropes "Demokracia nepermjet ligjit", me ç'rast vendit tone do t'i jepet statusi i anetarit shok prane ketij Komisioni, dhe ne Konferencen e 4-te te ministrave evropiane qe merren me çeshtjet e migrimit, e cila zhvillohet ne Luksemburg. Nderkohe, Sekretarja e Pergjithshme e Keshillit te Evropes, Catherine Lalumiere, ka ftuar ne Strasburg nje delegacion zyrtaresh te larte te MPJ per te diskutuar lidhur me modalitetet dhe fushat e bashkepunimit midis Keshillit te Evropes dhe Shqiperise.

Duke qene se gjate kesaj kohe ministri i Jashtem eshte i angazhuar ne veprimtari te tjera (mbledhja e Moskes, vizita e Presidentit ne Finlande), mendojme qe ne keto veprimtari te marre pjese zevendesministri i Puneve te Jashtme, Mhill Marku, i cili do te kryesoje edhe bisedimet me Keshillin e Evropes ne Strasburg.

Tirane, me 26 gusht 1991

3

*Conseil de l'Europe*
*Le Secrétaire Général*

*Référence :*

Strasbourg, le 30 mai 1991

Monsieur le Ministre,

De retour à Strasbourg, je tiens à vous exprimer mes remerciements pour l'excellent accueil que vous m'avez réservé lors de la visite que le Président du Comité des Ministres et moi-même avons effectuée à Tirana.

A cette occasion, nous avons pu noter l'expression de votre Gouvernement de poursuivre le processus de réforme démocratique entamé sur la base des principes et valeurs de pluralisme politique, de défense des droits de l'homme et de l'état de droit. Nous nous réjouissons de cette volonté de réforme et suivrons avec attention l'action gouvernementale sur cette voie.

Comme nous vous l'avons déjà indiqué, le Comité des Ministres du Conseil de l'Europe sera appelé à se prononcer sur l'ouverture de nos programmes de coopération et d'assistance à l'Albanie. Il ne manquera pas de garder à l'esprit vos lettres du 27 mai à cet égard. Pour ma part, je vous tiendrai informé des suites réservées à vos demandes.

Je vous prie d'agréer, Monsieur le Ministre, l'assurance de ma haute considération.

C. Lalumière

Catherine Lalumière

Monsieur Muhamet KAPPLANI
Ministre des Affaires Etrangères
Ministère des Affaires Etrangères
TIRANA
République d'Albanie

REPUBLIKA E SHQIPERISE
MINISTRIA E PUNEVE TE JASHTME

Drejtoria e Bashkepunimit Shumepalesh
dhe Organizatave Nderkombetare

Nr. ____ Tirane, me 18.11.1992

L e n d a: Per bashkepunim me Keshillin e Europes.

Kryesise se Kuvendit Popullor
Ministrise se Drejtesise
Ministrise se Rendit Publik
Ministrise se Punes, Emigracionit,
Perkrahjes Sociale dhe Perndjekurve Politike
Ministria e Arsimit
Ministria Kultures, Rinise dhe Sporteve
Ministria e Shendetesise
Gjykata e Kasacionit
Prokurorise se Pergjithshme
Radio Televizionit Shqiptar

T I R A N E

Ne kuadrin e orientimit te ri politik te vendit tone, bashkepunimi me Keshillin e Europes ze nje vend te rendesishem. Kjo organizate ka dhene nje kontribut te madh per procesin demokratizues ne Shqiperi, vecanerisht ne fushen ligjore, per reformen kushtetuese, te drejtave te njeriut, reformimin e drejtesise ne fushen sociale, kultures, arsimit, etj. Gjithashtu ajo ka mbajtur nje qendrim shume pozitiv dhe inkurajues per aderimin e vendit tone ne te, gje qe perben hapin e pare te domosdoshem te integrimit tone ne Europe.

Duke pasur parasysh nivelin e reformes demokratike ne Shqiperi, dhe rolin aktiv te kesaj organizate, u ra dakord, per nje iniciative te vecante te perkrahjes Europiane per reformen legjislative kushtetuese te te drejtave te njeriut ne Shqiperi.

Per konkretizimin e saj nga 30 Nentori deri 3 Dhjetor 1992, do te beje nje vizite ne Tirane nje delegacion i Funksionareve te Larte te Keshillit te Europes, i cili do te diskutoje ne terma konkrete veprimtarine per venien ne jete te ketij aktiviteti. Delegacioni

3/1

SESIONI I 88 I KOMITETIT TE MINISTRAVE TE KESHILLIT TE EVROPES
(25 prill 1991)

Me 25 prill 1991, ne Strasburg te Frances u zhvillua sesioni 88 i Komitetit te Ministrave te Keshillit te Evropes. Ne te u diskutua edhe çeshtja e marredhenieve te Keshillit te Evropes me vendet e Evropes Lindore e Qendrore. Ne deklaraten perfundimtare te sesionit lidhur me Shqiperine theksohet sa vijon:

"Ministrat moren ne shqyrtim gjendjen e krijuar ne Shqiperi pas mbajtjes se zgjedhjeve te para parlamentare te 31 marsit, per te cilat raportoi nje delegacion i posaçem vezhguesish nga Asambleja Parlamentare e Keshillit. Ata shprehen besimin se ritmi i reformes dhe i demokratizimit qe jane ndermarre do te pershpejtohet nga Parlamneti dhe qeveria qe do te krijohet pas zgjedhjeve.

Komiteti i Ministrave ishte i mendimit se reforma e gjithanshme dhe demokratizimi i plote i Shqiperise, i kombinuar me respektimin e plote te te drejtave te njeriut, do ta ndalonin eksodin e qytetareve te saj. Me perparimin e ketyre reformave, Keshilli i Evropes do t'i zhvilloje kontaktet dhe bashkepunimin e tij me Shqiperine, duke pare mundesine e hartimit te programeve te tij te ndihmes e bashkepunimit me te."

2

Keshilli i Evropes
Sekretarja e Pergjithshme

Strasburg, 30 maj 1991

Zoti Minister,

Tashme e kthyer ne Strasburg, deshiroj t'ju shpreh falenderimet e mia per pritjen e shkelqyer qe me rezervuat gjate vizites qe Kryetari i Komitetit te Ministrave dhe une beme ne Tirane.

Me kete rast ne mundem te konstatojme vendosmerine e Qeverise suaj per te vazhduar procesin e reformes demokratike te ndermarre ne baze te parimeve dhe vlerave te pluralizmit politik, te mbrojtjes se te drejtave te njeriut dhe shtetit ligjor. Ne gezohemi nga ky vullnet per reforma dhe do te ndjekim me vemendje veprimtarine e qeverise ne kete rruge.

Siç jua kemi bere tashme te ditur, Komitetit te Ministrave te Keshillit te Evropes do t'i kerkohet qe te prononcohet per hapjen e programave tona te bashkepunimit dhe ndihmes per Shqiperine. Ai nuk do te mungoje se mbajturi parasysh per kete qellim letrat tuaja te dates 27 maj. Nga ana ime, do t'ju informoj per pergjigjet ne vijim te kerkesave tuaja.

Pranoni, ju lutem, Zoti Minister, sigurimet e konsiderates sime te larte.

Catherine Lalumiere

ZOTIT MUHAMET KAPLLANI
MINISTER I PUNEVE TE JASHTME
T I R A N E
REPUBLIKA E SHQIPERISE

3

kerkon te takohet me personat pergjegjes per marredheniet me Keshillin e Europes ne dikasterin tuaj per te shqyrtuar kerkesat prioritetet si dhe sugjerimet tuaja per bashkepunim me kete organizate.

Lutemi beni pergatitjet e nevojshme per bisedimet me kete delegacion.

Per programin e detajuar te takimeve ne keto data do t'iu njoftojme me vone.

Zevendesministri

Arian Starova

**R E P U B L I K A  E  S H Q I P E R I S E**
**MINISTRIA E PUNEVE TE JASHTME**

**M I N I S T R I**

Tirane, me 6 prill 1995

I nderuar z. Sekretar i Pergjithshem,

Qeveria shqiptare ka marre dijeni dhe eshte e interesuar per hyrjen ne fuqi te "Konventes Kuader per Mbrojtjen e Minoriteteve Kombetare", e hartuar nga Keshilli i Europes dhe e hapur per nenshkrim me 1 shkurt 1995.

Deshiroj te shpreh opinionin e qeverise shqiptare se qellimet e kesaj Konvente perputhen plotesisht me politiken dhe legjislacionin tone, synimi i te cilave eshte t'u siguroje minoriteteve qe jetojne ne vendin tone garancite dhe mundesine e gezimit te standarteve me te larta europiane.

Duke ju refereruar nenit 27 te Konventes, sipas se cilit Komiteti i Ministrave mund te ftoje edhe shtetet jo anetare te Keshillit te Europes te nenshkruajne kete Konvente dhe me qellim te zbatimit sa me shpejt te angazhimeve qe rrjedhin prej saj krahas vendeve anetare te Keshillit te Europes, do t'ju lutesha t'i benit te ditur Komitetit te Ministrave deshiren tone per te qene te ftuar per ta nenshkruar ate sa me shpejt qe te jete e mundur.

Duke e pare vendimin e qeverise shqiptare si rrjedhoje logjike te te gjithe politikes se saj ne drejtim te te drejtave te njeriut ne pergjithesi dhe atyre te minoriteteve ne vecanti, deshiroj gjithashtu te shpreh bindjen se nje mase e tille do te kurorezoje perpjekjet tona per pranimin e shpejte te Shqiperise me te drejta te plota ne Keshillin e Europes.

Lutem pranoni i nderuar shkelqesi shprehjen e konsiderates sime me te larte.

Singerisht i Juaji

Alfred SERREQI

**H.E. Mr.Daniel TARSCHYS**
**Sekretar i Pergjithshem i**
**Keshillit te Europes**
**S T R A S B O U R G**

MPJ ARKIVI
Viti: 1995
Dosja Nr. Nr. Fleta:

Council of Europe
Conseil de l'Europe

MPJ ARKIVI
Viti: 1995
Dosja № 41 - Fleta:

*European treaties - Traités européens*

## Procès-verbal of signature - Procès-verbal de signature

On behalf of the Republic of Albania,
of the Framework Convention for the
Protection of National Minorities.

On the twenty-ninth day of June, One thousand Nine hundred and Ninety-Five, at the seat of the Council of Europe in Strasbourg, Mr Alfred SERREQI, Minister of Foreign Affairs of the Republic of Albania, signed the Framework Convention for the Protection of National Minorities, which was opened for signature by the member States of the Council of Europe and, up until the date when the Convention enters into force, by any other State so invited by the Committee of Ministers, in Strasbourg, on 1 February 1995.

In witness whereof this procès-verbal has been drawn up and signed by Mr Alfred SERREQI and Mr Daniel TARSCHYS, Secretary General of the Council of Europe, in two copies, of which one will be handed to the Minister of Foreign Affairs of Albania and the other deposited in the Archives of the Council of Europe.

| | |
|---|---|
| The Minister of Foreign Affairs of Albania, | The Secretary General of the Council of Europe, |
| Alfred SERREQI | Daniel TARSCHYS |

Council of Europe
Conseil de l'Europe

MPJ ARKIVI
Viti: 1995
Dosja № 4 Fleta:

*European treaties - Traités européens*

**Procès-verbal of deposit - Procès-verbal de dépôt**

On behalf of the Republic of Albania,
of the instrument of accession to the
Statute of the Council of Europe.

---

On the thirteenth day of July, One thousand Nine hundred and Ninety-Five, at the seat of the Council of Europe in Strasbourg, Mr Alfred SERREQI, Minister of Foreign Affairs of the Republic of Albania, deposited with the Secretary General of the Council of Europe the instrument of accession of the Republic of Albania to the Statute of the Council of Europe of 5 May 1949 (ETS 1).

In witness whereof this procès-verbal has been drawn up and signed by Mr Alfred SERREQI and by Mr Daniel TARSCHYS, Secretary General of the Council of Europe, in two copies, of which one will be handed to the Minister of Foreign Affairs of the Republic of Albania and the other deposited in the Archives of the Council of Europe.

The Minister of Foreign Affairs
of the Republic of Albania,

Alfred SERREQI

The Secretary General
of the Council of Europe,

Daniel Tarschys

Daniel TARSCHYS

DRESTORISE PERSONELIT

DRESTORISE FINANCES

2P 12.93
1068/1

Z. Dervishi 19.03.94

REPUBLIKA E SHQIPËRISE
Këshilli i Ministrave

# VENDIM

Nr. 579 datë 6.12.1993

PER

HAPJEN E PERFAQESIVE DIPLOMATIKE TE REPUBLIKES SE SHQIPERISE

Me propozimin e Ministrise se Punve te Jashtme, Keshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Te hapen perfaqesite diplomatike te Republikes se Shqiperise ne:

a) Ne kryeqytetin e Spanjes, Madrid, ambasade.

b) Ne qytetin e Holandes, Hage, ambasade.

c) Ne France, Strasbourg, Mision prane Keshillit te Evropes.

2. Ministrise se Puneve te Jashtme, ne planin e buxhetit per vitin 1994, t'i parashikohen fondet perkatese.

3. Per zbatimin e ketij vendimi ngarkohen Ministria e Financave dhe Ministria e Puneve te Jashtme.

Ky vendim hyn ne fuqi menjehere.

KRYETARI I KESHILLIT TE MINISTRAVE
ALEKSANDER MEKSI

Nr.prot.3312/1

Datë 13.12.1993

PRESIDENCËS
KUVENDIT POPULLOR
GJYKATËS KUSHTETUESE
GJYKATËS SË KASACIONIT
PROKURORISË SË PËRGJITHSHME
MINISTRISË SË DREJTËSISË
MINISTRISË SË PUNËVE TË JASHTME
MINISTRISË SË FINANCËS
SHËRBIMIT TË KONTROLLIT TË SHTETIT

SEKRETARI I PËRGJITHSHËM
VULLNET ADEMI